

**AKT I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"VALAMAR TALE" SHPK**

Sot më datë 12.03.2024 pala e mëposhtme:

- **Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi NUIS K72223031K, me adresë: Njësia bashkiake nr. 2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndërtesa nr. 12, Kati 11, Zyra nr. 1100, Kodi postar 1010, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, me letërnjoftim me nr. 038523830, banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e autorizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme datë 08.03.2024;

me nënshkrimin e këtij akti dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.

Neni 1 – Emërtimi dhe Forma e Shoqërisë

- 1.1 Shoqëria emërtohet **Valamar Tale SHPK** dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në vijim "**Shoqëria**").
- 1.2 Shoqëria themelohet në bazë të legjislacionit shqiptar dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Aktin e Themelimit dhe dispozitat e Statutit.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresë: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra nr. 1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/ose mbyllë, degë dhe/ose zyra përfaqësimi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar kohe.
- 3.2 Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Shoqëria ka objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuar më poshtë:
- a) Zhvillimin, projektimin dhe ndërtimin e objekteve civile dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë;
 - b) Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira;
 - c) Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, nëpërmjet ngritjes, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse (akomoduese) dhe të gjitha shërbimet direkt dhe indirekt të lidhura me to, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar;
 - d) Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argëtimit, bar, restorante në zona turistike etj.;
 - e) Administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa, në resorte apo struktura turistike dhe në komplekse rezidenciale;
 - f) Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj;
 - g) Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim dhe mos alterojnë objektin parësor të veprimtarisë së Shoqërisë;

Neni 5 – Kapitali dhe Kuotat

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 1000 LEK (një mijë lek), i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale prej 1000 Lek (një mijë lek).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
- Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, ka shlyer kontributin në Shoqëri, në para në shumën e barabartë me 1000 LEK (një mijë Lek).
- 5.3 Bazuar në kontributet e cituara më sipër:
- Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK zotëron 1 (një) kuotë, të barabartë me 100% (një qind për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 6 – Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen plotësisht ose pjesërisht në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 8 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 7 – Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator. Administratori do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tij do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.



- 7.2 Administratori përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, sipas parashikimeve të Statutit dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale (“*ad negotia*”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose Statuti.
- 7.4 Personi me poshtë emërohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
- Z. Andi Muhametaj, shtetas shqiptar, lindur më 15/07/1990, në Vlorë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër 036174966 dhe me numër personal J00715064S, i cili autorizohet personalisht ose duke autorizuar persona të tjerë, me anë të këtij akti që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë Valamar Tale SHPK, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe të regjistrojnë Shoqërinë pranë autoriteteve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe çdo dhe të gjitha autoriteteve shqiptare sikurse mund të kërkohet nga ligji i zbatueshëm në fuqi, përfshirë të drejtën për të nënshkruar aktet dhe dokumentet përkatëse në këto organe.

Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në Shqip.
- 8.2 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

Për

**Balfin – Balkan Finance Investment Group
SHPK**

Z. Edlira Muka - Administrator

